

HIB Petrol SH.P.K. Ferizaj



HIB PETROL

APLIKACION PËR LEJE MJEDISORE

Për stacionin e karburanteve HIB Petrol SH.P.K. Preoc, Graçanicë



Shtator, 2025

Shtojca 1**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

Emri i kompanisë	HIB Petrol SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	Stacioni i karburanteve, Preoc - Graçanicë
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	Astrit Topalli, përfaqësues i kompanisë
Adresa	Fshati Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj
Telefoni , fax, e-mail	+383 49 137 555
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Astrit Topalli, person kontaktues
Adresa	Fshati Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	✓ Certifikata e biznesit ✓ Certifikatat e pronësisë ✓ Kopjet e planit ✓ Dokument nga komuna ✓ Pëlqimi mjedisor
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	✓ Vlera investimeve 196 000 €
Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore	✓
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në pesë (5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	✓ 1 kopje fizike dhe një elektronike (CD)

Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	HIB Petrol SH.P.K.
	Vendi	Stacioni i karburanteve, Preoc - Graçanicë
	Adresa	Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë
	Nr. i tel./fax	+383 49 137 555
	E-mail	astrit.topalli@hibpetrol.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Nr. unik identifikues: 810662834 Data e regjistrimit: 30.03.2005
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Astrit Topalli, Përfaqësues i kompanisë
	Nr. i tel./fax	+383 49 137 555
	E-mail	astrit.topalli@hibpetrol.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Astrit Topalli
	Nr. i tel./fax	+383 49 137 555
	E-mail	astrit.topalli@hibpetrol.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	HIB Petrol SH.P.K. Stacioni i karburanteve, Preoc - Graçanicë
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1. Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur

Lokacioni i stacionit të karburanteve HIB Petrol SH.P.K. Stacioni i karburanteve, gjendet në dalje të Prishtinës, përkatësisht në te djathte te Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë , në parcelat kadastrale nr. P-73414058-00697-1, zona kadastrale Preoc, komuna Graçanicë. Në vijim paraqitja hartografike e lokacionit, fig. 1.



Fig1. Lokacioni i stacionit të karburanteve HIB Petrol SH.P.K. Preoc – Graçanicë.



Figura 2. Stacioni i karburanteve HIB Petrol SH.P.K. Preoc – Graçanicë.

2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni i stacionit të karburanteve HIB Petrol SH.P.K. Preoc - Graçanicë Stacioni i karburanteve, gjendet në dalje të Prishtinës, përkatësisht në të djathtë Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë.
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	<u>Lokacioni i HIB Petrol SH.P.K. Preoc - Graçanicë</u> Ngastra e stacionit të karburanteve HIB Petrol – në Preoc, Graçanicë, gjendet ne anën e djathte të rrugën Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, km 7, Preoc, Graçanicë, shih figurën 1 (lokacioni i stacionit te karburanteve) dhe figurën 2 (pamjen e stacionit te karburanteve me objektet përcjellëse). Objektet e stacionit te karburanteve - rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit, pompat për furnizim me karburant, streha e stacioneve te pompave, objekti administratë, market, restoranti, tualeti, terasa, këndi i lodrave për fëmijë, bodrumi, i cili shërben si depo për destinim përkatës dhe gardëroba për punëtorë. Në vijim pamjet e hapësirave në veri të stacionit të karburantit, figura ne vijim.  <i>Figura 3. Pamjet e stacionit të karburanteve.</i>

Në veri të HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë parcela kufizohet me objekte biznesore dhe objekti më i afërt gjendet ne distance rreth 100m, përtej saje hapësira te lire dhe tutje objekte tjera biznesore.

Pamjet në figurën ne vijim.



Figura 4. Pamjet veri të stacionit të karburanteve.

Në lindje - të HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë, parcela kufizohet me rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj, ku ka qasjen stacioni i karburanteve dhe përtej sajë objekte biznesore – afariste.

Pamjet në figurën në vijim.



Figura 5. Pamjet në lindje të stacionit të karburanteve.

Në jug të HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë, parcela kufizohet me rrugën lokale që të shpie të Hotel Emerald dhe përtej sajë me objekte afariste-biznesore, të cilat gjenden në distance rreth 100 m dhe hapësira të lira. Pamjet në figurën në vijim.



Figura 6. Pamjet në jug të stacionit të karburanteve.

Në perëndim të HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë, parcela kufizohet me parcelën tjetër me pronar të njëjtë me këtë të stacionit të karburanteve, përkatësisht me objektin e Hotel Emerald, i cili gjendet në distance rreth 60 metra nga vija kufizuese e parcelës dhe rreth 100 metra nga objekti i stacionit të karburanteve.

Pamjet në figurën në vijim.



Figura 7. Pamjet në perëndim të stacionit të karburanteve

Në bazë të këtij përshkrimi të gjendjes dhe gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme në mjedis, gjatë punës së stacionit të karburanteve.

2.4.

Të dhëna
lidhur me
florën dhe


Flora dhe fauna në zonën e ngushtë të lokacionit është tashme e ndikuar nga aktivitete biznesore dhe banimore, pasi kemi të bëjmë me një lokacion që ka kohë që është i destinuar për aktivitete të tilla biznesore.

Kemi të bëjmë me zone periferike të zonës urbane, që është e dominuar në

	fauna në atë lokacion	tersi me infrastrukture rrugore dhe objekte të kombinuara biznesore e banimore.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Zona e ngushte ku shtrihet ky aktivitet HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë, nuk është zonë e veçantë e mbrojtur.

2. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	<u>Procesi në stacionin e karburanteve</u>  <i>Figura 8. Paraqitja skematike e aktivitetit HIB Petrol SH.P.K. në Preoc, Graçanicë.</i>
--------	------------------------------	--

3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Pompa funksionon si pompe njëdrejtimëshe ka një hyrje dhe një dalje qendrore, po ashtu pjesa e administratës dhe furnizimit ka hyrje dhe dalje te veçante. I tere oborri është trajtuar me infrastrukture, kanalizim atmosferik, kanalizim i ujerave te zeza, rrjetin e ujësjellësit, sistemin e ujitjes si dhe sistemin e ndriçimit te oborrit. Funksioni i objektit Ky si objekt ka një funksion të përzier ku kemi hapësira administrative ne shërbim te konsumatorëve, hapësirat e shitjes, hapësirat gastronomike dhe hapësirat teknike dhe përcjellëse. Pajimet dhe objektet që përbëjnë kompleksin e stacionit të karburanteve: - Objekti i cili përmban hapësirën për administratë, hapësirën për shitjen, hapësirën për restorant me sipërfaqe rreth 700 m2 - Bodrumi me sipërfaqe rreth 700 m2, i destinuar si depo për deponim te materialeve përkatës, gardërobe dhe funksione tjera mbështetëse te këqij aktiviteti. - Terasa e restorantit me sipërfaqe rreth 280 m2 - Platoja e pompës rreth 600 m2 - Rezervarët e naftës (3) - Rezervarët e benzinës (3) - Rezervuari i gazit (1) - Pompa për naftë (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24) - Pompa për benzinë (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24) - Pompa për gazë (1) me aparatet për toçitje gjithsej (2) - Seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura. - Hapësirat e parkingjeve - Oazat gjelbëruese - Rrethoja e lokacionit. - Shtyllat e reklamës.
--------	--	--

Platoja e kompleksit

Platoja e stacionit të karburanteve është rregulluar ashtu që pjerrtësia të jetë e përshtatshme për përcjelljen e ujërave sipërfaqësore, të tërë pjesës për rreth objektit administrativ dhe për rreth objektit për shitjen e karburanteve është e betonuar. Organizimi për funksionimin e këtij stacioni të karburanteve është i destinuar për funksionimin e qarkullimit në rrugën ndërlidhëse, hyrja dhe dalja e automjeteve në kompleksin e stacionit të karburanteve bëhet pa pengesa sepse hapësira për hyrje në stacion të karburanteve dhe dalje është e mjaftueshme dhe dukshmëria është e mirë.

Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë

Në stacionin e karburanteve HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë janë vendosur rezervuar për depozitimin e naftës dhe benzinës me vëllim (figura në vijim):

V = 29891 litra, 31792 litra, 48657 litra, 29643 litra, 30072 litra, 49165 litra.

Rezervuarët e karburantit, figura në vijim.



Figura 9. Rezervuarët e karburantit - naftës, benzinës.

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të lëngtë Naftë dhe benzine dhe janë të vendosur nën tokë në pozitë horizontale, në hapësirën e betonuar dhe të rrethuar me mure betoni, të mbështetur në tri mbajtëset (shalat) nga betoni dhe të shtrënguara me nga dy shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforsimit për të mos lëviz nga presionet e ndryshme nëntokësore.

Mbrojtja nga korrozioni bëhet për mes sistemit të katodës dhe me ngjyrë konform standardeve.

Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve bëhet nëpërmjet të sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale.

Rezervari për karburant të gaztë

Në stacioni i karburanteve HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, është i vendosur edhe rezervari për deponim dhe distribuim të karburantit të gaztë (propan-butan) me kapacitet prej 15000 litra. Rezervuari i gazit, fig. në vijim.



Figura 10. Rezervari i gazit

		Rezervari cilindrik është i vendosur ne tokë në pozitë horizontale, i përforcuar dhe vendosur ne mënyrë profesionale, ne baze te projektit kryesore te ndërtimit te stacionit te karburanteve. Rezervari do është i ndërtuar prej çelikut sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të gazta për të cilin ekzistojnë dëshmitë nga prodhuesi. Siguria aksidentale zvogëlohet pasi rezervari është i vendosur nëntoke. <u>Karakteristikat e procesit ne stacionin e karburanteve</u> Procesi teknologjik në stacionin e karburanteve do të përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mes veti. - sistemi për zbrazje - sistemi për deponimin e karburanteve - sistemi për dhënien (toçitjen) e karburanteve Sistemi për zbrazje të karburanteve të lëngët bëhet nga autocisternat me ramje të lirë (apo me anë të pompës) përmes sistemit të gypave prej gome, të cilët përmes një kyçje speciale lidhen me gypin në rezervuar. Matja e sasisë së deponuar në rezervuar do të matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse të vendosur ne autocisternë ose përmes levës së bazhdaruar dhe tabelave të veçanta për çdo rezervuar. Sistemi i gypave dhe instrumenteve matëse kontrollohen para zbrazjes, në mënyrë që të eliminohen dukuritë e situatave aksidentale. Sistemi për deponim të karburanteve përbëhet nga dy rezervar për depozitim të naftës, dy rezervuara te benzinës dhe një rezervari për karburant të gaztë (propan-butan). Kapaciteti i këtyre rezervuarve është përshkruar me larte. Sistemi për dhënien apo toçitjen e karburanteve të lëngët te naftës dhe benzinës, përbëhet nga 12 +12 pompa me nga 24 + 24 gypa për toçitje dhe një pompe me 2 gypa për toçitje te gazit. Sistemi për dhënie të karburanteve
--	--	---

		funksionojnë ne mënyrë automatik dhe janë të mbrojtur nga rreziqet eventual. <u>Komponentët hyrëse në procesin teknologjik</u> Komponentët hyrëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë: - Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë). - Karburant të gaztë (propan-butan) - Energjia elektrike dhe uji. Karburantet djegëse te lëngëta benzina dhe nafta shërbejnë për furnizimin e automjeteve, për nevoja ne amvisni ne industri etj. Sasia e përgjithshme e karburanteve ne stacionin e karburanteve (nafte dhe benzine) është dhënë ne piken me larte. Karburantet e gaztë (propan-butan) shërbejnë si lëndë djegëse për automjete, në amvisëri apo në industritë e ndryshme si dhe për automjete që shfrytëzojnë gazin si lëndë djegëse. Sasia e karburanteve të gazta ne stacionin e karburanteve është dhen më lartë. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për larjen e platosë së stacionit të karburanteve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit. Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve Furnizimi me ujë në kompleksin e stacionit të karburanteve i cili shfrytëzohet për qëllime sanitare bëhet nga sistemi i ujësjellësit. <u>Komponentët dalëse në procesin teknologjik</u> Komponentët dalëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë:
--	--	---

		- Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë) dhe gazta (propan-butan). - Ujërat e ndotura - Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga automjetet - Zhurma - Mbeturinat e ngurta.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	E Hënë – E Diele Orari i punës: 24 orë, në 7 ditë të javës
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	- Rezervuar për depozitimin e naftës dhe benzinës me vëllim: V = 29891 litra, 31792 litra, 48657 litra, 29643 litra, 30072 litra, 49165 litra. - Rezervuari i gazit me kapacitet prej 15000 litra Kapaciteti është si në këtë shënim, ndërsa sasia e shitur varijon sipas kërkesave të konsumatorëve.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve që zhvillohen në janë: - Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzina) - Ujërat - Energji elektrike.
3.1.6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	- Rezervuar për depozitimin e naftës dhe benzinës me vëllim: V = 29891 litra, 31792 litra, 48657 litra, 29643 litra, 30072 litra, 49165 litra. - Rezervuari i gazit me kapacitet prej 15000 litra
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Për realizimin e këtij aplikacioni për leje mjedisore, stacionin e karburanteve, janë marrë për bazë ligjet me relevante për këtë qellim, si më poshtë:

		- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 - Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023) - Ligji për Vlerësimin Strategjik në Mjedis, Nr.03/L-230) - Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022) - Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina - Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 - Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 - Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 - Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26 - Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233 - Ligji nr.08/L-275 për rrugët, Ndryshim - Plotësim i Ligji nr. 2003/11 Ligji për rrugët , shfuqizim i ligji nr.03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin (Nëntor 2024), - Ligji për kimikate Nr. 04/L-197 - Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102 - Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012 - Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë. - Ligji nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësi Publike. - Ligji nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. - Udhëzim administrativ (MMPHI) NR. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MMPHI) nr. 04/2022 për Leje Mjedisore. - Udhëzim administrativ Nr. 04 /2022 për Lejes Mjedisore - Udhëzim administrativ Nr. 01 /2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale. - Udhëzim administrativ nr. 18 /2024 për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje mjedisore të integruar.
--	--	--

		- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor. - Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes - Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme - Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponisë së mbeturinave - Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave - Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës - Udhëzimi administrativ Nr.05/2013. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra. - Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale
--	--	---

3.2. Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit		
3.2.1.	Sistemi Menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Kjo kompani nuk e ka të zhvilluar sistemin e menaxhimit mjedisor bazuar në ISO 14001 - standardin për cilësi të Mjedisit (ISO 14001). Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e menaxhimit mjedisor japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: - parandalimin e dëmtimit të mjedisit - përmirësimin e vazhdueshëm i mjedisit - respektimin e legjislacionit vendor - përmirësimin e komunikimit me autoritetet.
3.2.2.	Raportimi	Raportimi i Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, realizohet sipas kërkesave ligjore, sipas kërkesave të MMPHI.

4. AJRI		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Pluhurat të cilët lirohen nga automjetet të cilat qarkullojnë brenda dhe jashtë kompleksit të stacionit të karburanteve. Gazrat të cilat lirohen nga automjetet të cilat qarkullojnë brenda dhe jashtë kompleksit të stacionit të karburanteve. Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Gjatë funksionimit kontinuel të HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrimet të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë: CO, NOx, HxCy, SO2 dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike - meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga ndotja që vjen nga qarkullimi i automjeteve brenda hapësirave të stacionit të karburanteve dhe jashtë tij, përkatësisht në rrugën magjistrale ku gjendet stacioni i karburanteve.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, nuk ka pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese pasi që gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve përveç që kontrollohen ventilet sigurues dhe pajisjet për toçitjen e karburanteve.

4.5.	Pajisjet për de-pluhurin	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative nga veprimtaria e kompanisë HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, kompania ka marrë këto masa: - E gjithë hapësira e stacionit të karburanteve spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta. - Kontrollohen ventilet sigurues dhe pajisjet për toçitjen e karburanteve. - Vëmendje ju kushtohet hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtjes së tyre.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, nuk bën monitorimin e emisioneve, por bën matje në raste të kërkesave specifike nga ministria e mjedisit ose komuna, sipas kërkesave ligjore nga MMPHI.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë së ajrit	Nuk ka monitorim kontinual - matjet realizohen sipas kërkesave eventuale të MMPHI. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂. Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet nga kushtet klimatike - meteorologjike dhe numri automjetet e transportit dhe ngarkimit të betonit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe produkteve të betonit, përveç masave të lartë cekura kompania, ka ndërmarrë këto masa: - Bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve e sidomos stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve. - Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i pajisjeve. - Bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve, kryesisht gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.

4.8.	Raportimet	Raportimi te rregullta nuk ka, nga kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc, Graçanicë, por do të kryhet nëse kërkohet, sipas kërkesave ligjore nga ministria e mjedisit, të cilat do të jene publike për komunitet lokal, institucionet komunale dhe palët tjera te interesit.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative nga veprimtaria e kompanisë HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, kompania ka marrë këto masa: - E gjithë hapësira e stacionit te karburanteve spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta. - Kontrollohen ventilet sigurues dhe pajisjet për toçitjen e karburanteve. - Kontrollohet gjendja fizike e rezervuarve te karburanteve, - Kontrollohet dhe mirëmbahet sistemi i grumbullimit te ujerave ne hapësirat e platesë se stacionit te karburanteve, etj.
4.10	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	- Mirëmbajtja e pompave dhe mbikëqyrja e rezervuarve, te mos emetohen avuj te karburanteve te cilat ndikojnë ne efektin serre. - Përdorimi i klimave – kondicionerëve me efecient qe lirojnë me pake gazra serre - Kursimi i energjisë – përdorimi i ndriçimit LED dhe pajisjeve efikase. - Minimizimi dhe menaxhimi i mire i mbetjeve si mase parandaluese e ndikimeve ne mjedis - Karburante më kualitative, me të pastra – ofrimi i karburanteve me ndotje të ulët, ofrimi i gazit si lende djegëse me ekologjike - Pika për furnizim për automjete elektrike – vendosja e karikuesve për vetura elektrike. - Vetëdijesimi – Informimi dhe trajnimi i stafit për ruajtjen e mjedisit.

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Në kompaninë HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, nuk gjenerohet ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi që uji nga shpëlarja e sipërfaqeve punuese, para se të shkarkohet në recipient kalon neper pusin grumbullues të ujërave të zeza - separatorin dhe aty trajtohet, andaj edhe nuk ka emisione të ujërave të ndotura.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Ujërat për qëllime të stacionet të karburanteve merren nga ujësjellësi publik dhe si të tilla përdoren për sanitari, shpëlarje dhe qëllime tjera. Pas përdorimit ujërat sanitare shkarkohen direkt në rrjetin e kanalizimit të qytetit. Ujërat shpëlarës të platose së hapësirave punuese të stacionit të karburanteve dhe hapësirave përreth, grumbullohen dhe dërgohen në separator neutralizues dhe pastaj shkarkohen në rrjet të kanalizimit, sikur veprohet edhe më ujërat nga reshjet atmosferike.
5.3.	Ndikimet në ujë	Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri të shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve. Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vjen deri të sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara, i fundërrimeve nga atmosfera. Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të stacionit të karburanteve pritet të jenë gjatë zezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër magjistrale.

		Koncentrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e stacionit të karburanteve drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të automjeteve. Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentrimet më të mëdha janë në 5 -10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së platosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike. Derdhja e derivateve si nafta pastaj vajrat ndikojnë në cilësinë e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, andaj janë marre te gjitha masat qe te evitohen këto mundësi.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, nuk ka bërë matjen e cilësisë të ujit i për të përcaktuar emisionet e ujërave të ndotura - treguesin e emisioneve kryesore, koncentrimet dhe sasinë vjetore. Do te veproj sipas kërkesave te Ministrisë se Mjedisit.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, ka ndërtuar sistemin për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet e hapësirave punuese (platoja e pompave te karburantiti) ujëmbledhësin – deri te separatori i ujerave.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë , ujërat të cilët përdorën për pastrimin e punëtorëve, ujërat sanitare shkarkohen në rrjetin e kanalizimit. Ujërat nga sipërfaqet manipuluese përmes sistemit për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura do të kalojnë në seperatorin përkatës – ujëmbledhësi i ujërave dhe me këto do të minimizohen mundësia e depërtimit te tyre në ujërat nëntokësore.
5.7.	Raportimi	Raportimi bëhet konform kërkesave ligjore, kërkesave të Ministrisë së Mjedisit.

5.8.	Leje ujqorë për shfrytëzim të ujit	Kompania HIB Petrol sh.p.k. Preoc - Graçanicë, ujin e shfrytëzon nga ujësjellësi dhe paguan për ujin e shfrytëzuar.
5.9.	Leje ujqorë shkarkimin e ujërave	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, shfrytëzon ujin nga ujësjellësi dhe kryen pagesat për ujin qe shfrytëzon.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, ne kuadër te investimeve ne infrastrukturën e saj - ujërat nga sipërfaqet manipuluese përmes sistemit për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura - kalojnë në seperatorin e ujerave – mbledhësi i ujërave dhe me këto ë minimizohen mundësia e depërtimit te tyre në ujërat nëntokësore.

6. ZHURMA

6.1.	Burimet	Lokacioni ku është vendosur HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga faktorët e ndryshëm si: qarkullimit te automjeteve transportuese brenda dhe jashtë kompleksit të stacionit të karburanteve, nga puna e gjeneratorit ne mungesë të rrymës elektrike.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk ka bërë kontroll dhe matje të zhurmës, pasi nuk i është kërkuar.
6.3.	Raportimet	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk ka bere raportime pasi qe nuk ka bere matje të zhurmës, te njëjtat nuk janë kërkuar.

7. TOKA		
7.1	Ndikimet në tokë	Nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të tokës. Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platos së stacionit të karburanteve dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri. Kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin . Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platos së stacionit të karburanteve, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e stacionit të karburanteve. Ndikime negative të mundshme në mjedis paraqiten në tokë nga: - Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga aktiviteti - Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të stacionit të karburantit, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. - Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga qarkullimi i automjeteve (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese. - Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit me karburant dhe shpërndarjes - shitjes së tij.

7.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Gjate fazës së kryerjes së aktiviteteve në stacionin e karburanteve për të parandaluar sasinë e ndikimeve në tokë kompania ka marrë këto masa - Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative në hapësirat operacionale në të cilat bëhet manipulimi me karburante është i asfaltuar dhe izoluar - Kompania ka vendosur enët adekuate për deponimin e mbeturinave - Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat e përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshme në tokë grumbullohen në kolektorë dhe përmes sistemit përkatës përcjellën në pusin filtrues.
7.3	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të funksionimit të kompanisë HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, objektet ekzistuese do të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi inerte regjionale. Të gjitha mbetjet e mbeturinave ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë të kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethinë të lokalitetit, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Menaxhimin e mbeturinave e bënë ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat të ngurta komunale grumbullohen, dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm. Ujerat sanitare shkarkohen direkt ne kanalizimin publik, ndërsa ujërat sipërfaqësore nga stacioni i karburantit dërgohen përmes separatorit dhe pastaj shkarkohen ne kanalizimin. Mbeturina qe Komunale qe gjenerohen, ne baze te Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013per katalogun shtetërore te mbeturinave: <table><tr><th><i>Mbeturina komunale</i></th><th><i>Emri i mbeturinës</i></th><th><i>Shkalla e rrezikshmërisë</i></th><th><i>Lloji i deponimit</i></th></tr><tr><td><i>20 01 01</i></td><td><i>Letra dhe karton</i></td><td><i>Jo të rrezikshme</i></td><td><i>Kontejner</i></td></tr><tr><td><i>20 01 08</i></td><td><i>Mbeturina te biodegradueshme nga kuzhina dhe restorani</i></td><td><i>Jo të rrezikshme</i></td><td><i>Kontejner</i></td></tr><tr><td><i>20 01 39</i></td><td><i>Plastika</i></td><td><i>Jo të rrezikshme</i></td><td><i>Kontejner për mbeturina</i></td></tr><tr><td><i>20 03 99</i></td><td><i>Mbeturinat komunale te pa specifikuara ndryshe</i></td><td><i>Jo te rrezikshme</i></td><td><i>Kontejner për mbeturina</i></td></tr></table>	<i>Mbeturina komunale</i>	<i>Emri i mbeturinës</i>	<i>Shkalla e rrezikshmërisë</i>	<i>Lloji i deponimit</i>	<i>20 01 01</i>	<i>Letra dhe karton</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner</i>	<i>20 01 08</i>	<i>Mbeturina te biodegradueshme nga kuzhina dhe restorani</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner</i>	<i>20 01 39</i>	<i>Plastika</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner për mbeturina</i>	<i>20 03 99</i>	<i>Mbeturinat komunale te pa specifikuara ndryshe</i>	<i>Jo te rrezikshme</i>	<i>Kontejner për mbeturina</i>
<i>Mbeturina komunale</i>	<i>Emri i mbeturinës</i>	<i>Shkalla e rrezikshmërisë</i>	<i>Lloji i deponimit</i>																			
<i>20 01 01</i>	<i>Letra dhe karton</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner</i>																			
<i>20 01 08</i>	<i>Mbeturina te biodegradueshme nga kuzhina dhe restorani</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner</i>																			
<i>20 01 39</i>	<i>Plastika</i>	<i>Jo të rrezikshme</i>	<i>Kontejner për mbeturina</i>																			
<i>20 03 99</i>	<i>Mbeturinat komunale te pa specifikuara ndryshe</i>	<i>Jo te rrezikshme</i>	<i>Kontejner për mbeturina</i>																			
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Gjatë aktivitetit te kompanisë HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk bën magazinimin e përkohshëm te mbeturinave, por mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak.																				
8.3	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit te kompanisë HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk bëhet përpunim dhe riciklimi e mbeturinave.																				

8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, mbeturinat nuk gjeneron mbeturina që të dërgohen për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër, mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e autorizuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale. Ujerat sanitare shkarkohen në kanalizimin publik, ndërsa ujërat sipërfaqësore nga stacioni i karburantit trajtohen përmes separatorit dhe pastaj shkarkohen në kanalizimin.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk ka hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave. Mbeturinat që gjenerohen janë mbeturinat sanitare, hedhe në kontejnerit që menaxhohen nga kompania publike e mbeturinave. Menaxhimin e mbeturinave e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat të ngurta komunale grumbullohen, dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm. Ujerat sanitare shkarkohen në kanalizim, ndërsa ujërat sipërfaqësore nga stacioni i karburantit trajtohen përmes separatorit, dhe pastaj shkarkohen në kanalizim.
8.6.	Raportimi	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk ka raportime periodike në MMPHI. Pas pajisjes me leje mjedisore, do të veprohet sipas kërkesave të Lejes Mjedisore, përkatësisht MMPHI.

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

Me që kemi të bëjmë me stacionin e karburanteve ku do të kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale .

Në rastet e jo zakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve të lëngët mundë të vjen deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mundë të jetë i shkallëve të ndryshme.

Nga manipulimet e ndryshme vepruese me derivatet e naftës në stacionin e karburanteve mundë të vjen deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e stacionit dhe hapësirën për rreth tij. Në aspektin teorik aksidentet e një shkalle më të lartë në stacionin e karburanteve mundë ndodhin në rezervuarët me karburante të vendosur në tokë e sidomos gjatë derdhjes (rrjedhjet) si dhe nga auto cisternat.

Sa i përket zjarrit mundë të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri kur kemi parasysh faktin se do të ekziston “projekti kundër zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri” si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirren gjatë një aksidenti nga zjarri.

Me që kemi të bëjmë me stacionin e karburanteve ku do të kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët dhe të gaztë nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale .

Në rastet e jo zakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve të lëngët mundë të vije deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mundë të jetë i shkallëve të ndryshme.

Nga manipulimet e ndryshme vepruese me derivatet e naftës në stacionin e karburanteve mundë të vije deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e stacionit dhe hapësirën për rreth tij. Rrezikimi i mjedisit në stacion në rastet aksidentale buron edhe nga prania e gazit të lëngët naftor (GLN) të deponuar në stacionin e karburanteve.

Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrina në rezervar)

Ngjarjet e mundshme në këtë rast janë:

- formimi i resë e cila lëvizë
- inicimi me krijimin e resë së avullit që eksplodon
- shkaktimi i zjarrit

- pa inicim

Aksidenti në sistemin shpërndarës

Aksidenti në këtë rast është pasojë e rrjedhjes (derdhjes) së GLN-së nga sistemi shpërndarës dhe mund të çojë deri te:

- flaka kur vjen lëvizja deri te iniciimi
- formimi i resë dhe lëvizja e saj me:
- inicim dhe formim të resë së avullit e cila eksplodon,
- shkaktim të zjarrit
- ose nuk ka inicim
- të punësuarit në kompleks

Në bazë të analizës së lëndueshme risë mund të vlerësohet se në situatën më të pafavorshme (15m3 GLN), pasojat e mundshme të aksidentit do të shpreheshin deri në distancë rreth 14 m.

Siguria aksidentale zvogëlohet pasi rezervari do të vendoset nën tokë prandaj pasojat e mundshme të aksidentit do të shpreheshin në distancë më të vogël.

Objektet e banimit janë të larguara në distancë të mjaftueshme nga rezervari i GLN-s, prandaj nuk dot ketë ndikime nga aksidentet e mundshme për njerëzit që banojnë ne objektet e lartcekura.

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, nuk ka hartuar planin për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut / plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm, por tregon kujdes të shtuar që të mos vjen deri te ndonjë aksident mjedisore.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc - Graçanicë, nuk përdorë substancave të rrezikshme kimike dhe preparate.

9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, ka marrë këto masa: Rezervarët për lëndë djegëse të lëngtë dhe të gazta (butan, propan) janë blerë nga prodhuesi te cilët janë të prodhuar sipas standardeve dhe janë të vendosur po ashtu sipas standardeve. - Ne rezervarët e lëndëve djegëse të gazta (propan butan) është i vendosur sistemi për sjelljen e ujit për ftohje të rezervarit ne kohëra me temperatura të larta. - Ne rezervarin e lëndëve djegëse të gazta (butan, propan) është i vendosur një kulm mbi rezervar për pengimin e rrezeve të diellit drejtpërdrejt ne te. - Të gjithë gypat ajruar të rezervarëve janë të vendosur ne lartësi të sigurt. - Kompania rezervarët e karburanteve i kontrollon për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv - Në mënyrë permanente të mirëmbahet mjedisi në kompleksin e stacionit te karburanteve - Në mënyrë permanente monitorohet kompleksin stacionit te karburanteve Ndalohet ndezja e mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta brenda lokacionit - Punëtorët e stacionit te karburanteve e kontrollojnë sistemin e gypave me mekanizëm për mbushje dhe zbrazje të karburanteve nga rezervarët. - Kompania ka siguruar pajisjeve kundër zjarrit si dhe enët me rërë.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, posedon rezervuar për deponimin e karburanteve dhe

		kujdeset për mirëmbajtjen e këtij rezervuarit dhe sigurinë e tij, sipas procedurave përkatëse.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, posedon rezervuar për deponimin e karburanteve dhe kujdeset për mirëmbajtjen e këtij rezervuarit dhe sigurinë e tij, sipas procedurave përkatëse. Kompania ka marrë masat e sigurisë kundër vënies së qëllimshme të zjarreve duke e monitoruar kompleksin e bazës së betonit.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nga qarkullimet e automjeteve në stacionin e karburanteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve . Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve, rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara. Ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve dhe nga fundërrimit e komponentëve ndotëse nga ajri. Gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të rezervuarëve, pajisjeve etj.
-------	---	--

10.2.	Ndërprerja e punës	Nuk ka ndërprerja momentale e punës së impiantit
-------	--------------------	--

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut

Gjatë funksionimit kontinuel të kompanisë HIB Petrol sh.p.k. stacioni i karburanteve Preoc – Graçanicë, posedon rezervuar për deponimin e karburanteve, kujdeset për mirëmbajtjen e këtyre rezervuarit dhe stabilimenteve përcjellëse të stacionit të karburanteve, sigurinë e tyre, sipas procedurave përkatëse.

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është minimal pasi kompania ka marrë të gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër, tokë, ujë, sipas përshkrimeve në kapitujt (pikat) paraprahe.

HIB Petrol SH.P.K.

HIB Petrol SH.P.K.

Personi përgjegjës për mjedis

Personi përgjegjës i kompanisë

SHTOJCA 1

Procesi në stacionin e karburanteve

Sistemi për zbrazje

Sistemi për deponimin e karburanteve

Sistemi për dhënien (toçitjen) e karburantëve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BISENEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810662834

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Hib Petrol SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

**Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies**

Adresa:
Adresa:
Address:

**Magj. Ferizaj-Prishtinë
Talinovc i Muhaxherëve
Ferizaj**

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

30/03/2005

25/02/2019

Data / Date / Datum



[Signature]

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10002098**



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810662834

Aplikacioni / Application / Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject:
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:
Filling date:
Datum:

Data e pranimit:
Reception date:
Datum primljenje:

Numri i protokollit:
Protocol number: 125009889
Broj protokola:

Biznesi / Business/ Biznis

Tipi i biznesit
Business Type
Tip biznisa
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Limited Liabilities Companies
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:
Business name:
Naziv biznisa:
Hib Petrol SH.P.K.

Emri tregtar:
Trgovačko ime:
Commercial name:
///

Adresa
Address
Adresa
Magj. Ferizaj-Prishtinë
Talinoc i Muhaxherëve
Ferizaj

Data e themelimit:
Date of establishment:
Datum osnivanja:
30/03/2005

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital:
Totalni kapital:
€ 2,830,000.00

Numri i punëtorëve:
Number of employees:
Broj radnika:
750



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810662834

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 70249534 , me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810662834

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810662834

Veprimtaritë / Activities / Delatnosti

